

## Historiku i kultivimit të bimës së misrit në Shqipëri

Prof.As. Dr. Kostandin Hajkola  
QTTB Shkodër

“Në familjen e graminaceve bëjnë pjese shume gjini, numri i te cilave arrin nga 450-530, ndërsa speciet janë afro 5000. Ne gjininë Zea, qe përfshihet ne grupimin e graminaceve me te rëndësishme si bime ushqyese për njeriun, gjejmë Zea Mays ose misrin, origjina e te cilit përben akoma sot një problem, për disa versione akoma te pa zgjidhura për botanistët, pse ajo është e panjohur ne gjendje te egër, porse është e qarte, qe bima te jete kultivuar qe ne periudhën parakolumbiane”. (R. Bartolini)

“Emërtimi i pare shkencor “Zea Mays” i përket natyralistit ta madh suedez, Lineut. Ne greqisht fjala Zea do te thotë “jete” (A.Domi). Sipas J.P.Gay “Misri është e vetmja bime, nder kulturat e mëdha, qe nuk gjendet ne gjendje te egër. Qe prej mijëra vjetësh është njeriu, qe pasi e krijoi misrin e mban atë ne jete.” Ndërsa sipas Dupont Ph. “Misri është një prej trashëgimive kryesore, qe na ka lënë qytetërimi parakolumbian i Amerikës Qendrore, qe e kane kultivuar qe 5000 vjet para erës se re dhe konsiderohet një nder tre drithërat e pare te kultivuar ne bote.”

Ne përpjekje për përcaktimin e origjinës gjenetike te bimës se misrit, botanistët për një kohe te gjate grumbulluan dhe herbarizuan bime te shumta. “Ne fund te shekullit te XVIII-te, sipas Eëatherëax. P. dhe Randolph L.F., kur u gjeten gjinitë e afërta me misrin *Tripsacum* dhe *Euchlaena*, interesi për këtë problem u përteri”.

Ne vazhdën e këtyre kërkimeve sipas R.Bartolinit “Disa e konsiderojnë misrin një forme shume te ngjashme e *Euchlaena mexicana* e Meksikës (bime e kultivuar, me emrin Teosinte, si foragjere, ne zonat me te ngrohta te Amerikës), prej se çiles ndoshta ka rrjedhe nëpërmes te një procesi te mutacionit gjenetik, ose te ndryshimeve te papritura e te ndërprera, qe shfaqen ne substancën trashëguese te përmbajtjes gjenetike individuale”

Ne vitin 1978 ne Meksike u gjet një bime tjetër e familjes graminace e cila u emërtua “Misri diploid shumëvjeçar” (*Zea Diploperenis-Iltis Doepley et Guzman*). Emërtimi paraqet një veçori te rëndësishme te bimës, ku diploiditeti ( $2n=20$ ), jep mundësinë e kryqëzimit me kulturën e misrit (E.E.Gogin V.I.Ro-sinski). Por dhe me këtë gjetje, qe u konsiderua një zbulim i madh botanik i shekullit prejardhja gjenetike e misrit mbeti një dosje e hapur për studim.

Për sa i përket vendit te origjinës, tashme prej shume studiuesve është pranuar se është rajoni i Amerikës suptrorikale e ne mënyre me te sakte Meksika e Peruja, ku dhe është vërtetuar prania arkaike e misrit (Misri ne vitet '80).

Hyrja e misrit ne Evrope është atribut i Kristofor Kolombit, te cilin ai e solli ne fillim te vitit 1493 ne Spanje, kur u kthye nga udhëtimi i tij i pare ne Amerike. Bima e re ose “mais”, siç e quanin banoret e kontinentit te ri, sipas E.C.Galinat” u përhap ne Evrope, Afrike e Azi gjate shekullit XVI me ane te detarëve te mëdhenj”

Ne Shqipëri misri daton te jete kultivuar rreth mesit te shekullit XVII, sipas një relacioni te F Bardhit te vitit 1641 fillimisht ne fshatin Blinishtë (zona e Zadrimës, Lezhe) i njohur me emrin sorgus (Xhepa S). Ne fakt mbërritjen e kësaj kulture ne vendin tone te tjera duhet ta kërkojmë qe ne mesin e shekullit 16-te, pasi ne disa zona si Luginat e Dibrës, fushat e Elbasanit etj, taksa e drithit jepej edhe si misër (me emërtime kollomboq, grurë Misiri etj). Nga ana tjetër, numri i madh i popullatave lokale te kultivuara deri ne vitet 50 te shekullit te kaluar ne një territor te vogël si Shqipëria, janë tregues te hershmërisë se kultivimit te kësaj bime jetike.

%